

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Auditim
(zgjidhjet)

P6

Nr.

FLETË PROVIMI

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.

Data 01/10/2016

Detyra 1

Drejtorët e Konstruksioni Shpk i kanë kërkuar firmës suaj të japë ofertën e saj për shërbime të auditimit në mënyrë që të shqyrtojnë emërimin e firmës suaj si auditorët e rinj të Konstruksioni Shpk. Pasqyrat e ardhshme financiare që do të auditohen do të jenë ato të vitit që mbaron në datën 31 dhjetor 2016 dhe nga diskutimet e bëra me drejtorët, partneri i firmës suaj përgjegjës për angazhimet e auditimit ka vërtetuar informacionet e mëposhtme:

(a) Konstruksioni është një kompani me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar para shumë kohësh dhe që ushtron veprimtarinë e tij si tregtar i pajisjeve të ndërtimit. Për shkak të një fluksi të madh të konkurrentëve në treg, kompania ka pasur rënie në fitime vitet e fundit, megjithëse drejtorët nuk duket se edhe mërzhiten shumë për këtë sa i takon aftësisë së kompanisë për të vazhduar aktivitetet e saj afariste.

(b) Kompania ushtron veprimtarinë në 14 lokacione të shpërndara në të gjithë vendin. Të gjitha lokacionet përbëhen nga një dyqan dhe një depo, ndërsa në lokacionin më të madh të kompanisë ndodhen njëkohësisht edhe zyrat e saj kryesore. Në mënyrë që të tërhiqen klientë të rinj, të gjitha dyqanet janë riparuar dhe ri - mobiluar sipas një programi për rinovim i cili është adoptuar nga kompania. Kostot e këtyre programeve janë domethënëse dhe janë financuar nga hua bankare.

(c) Secili lokacion shet një gamë të gjerë produktesh përfshirë lëndë drusore dhe materiale konsumi, bashkë me produkte për dekorim dhe ndërtim të përgjithshëm. Njëkohësisht në dispozicion të blerësve vihen edhe pajisje dhe vegla, edhe për shitje edhe për t'u marrë me qira për një kohë të shkurtër, ndërsa në secilën depo ka rërë dhe zhavorr për të përmbushur menjëherë kërkesat e klientëve.

(d) Për shumicën e klientëve zbatohet një politikë e shitjeve me para në dorë. Kur lejohen shitje me kredi, klientëve iu mundësohet ose marrja e mallrave në dorëzim menjëherë, ose dërgimi i tyre në ambientet e vetë klientit me shpenzimet e kompanisë.

(e) Konstruksioni ka në pronësi një numër të madh të impianteve dhe makinerive lëvizëse të prodhimit të cilat përmbushin porositë që merren nga dyqanet ose drejt për drejt nga klientët. Këtu përfshihen ekskavatorë, kamionë vetë - shkarkues, kamionë të thjeshtë dhe kamionçina.

(f) Secili lokacion është i hapur gjatë gjithë vitit, dhe mbyllet vetëm me rastin e pushimeve publike. Për këtë arsye secili lokacion punëson 18 persona si personel me kohë të plotë të dyqanit dhe depo, pa llogaritur këtu edhe numrin e ndryshueshëm të punonjësve me kohë të pjesshme (punonjës të përkohshëm).

Kërkohet:

(a) Përshkruani TRE çështjet që duhet të mbajë parasysh partneri për angazhime të auditimit i firmës suaj para së të marrë një vendim për dhënien e një çmimi për t'u emëruar si auditorët e Konstruksioni. (10 pikë)

(b) Përshkruani, duke dhënë edhe arsyet, PESË faktorët të cilët do të kenë ndikim mbi vlerësimin fillestar të rrezikut të vetvetishëm që kanë të bëjnë me auditimin e pasqyrave financiare të Konstruksioni - it. (10 pikë)

(c) (i) Shpjegoni qëllimin e letrës së angazhimit (2 pikë)

(ii) Përshkruani gjashtë çështje të rëndësishme që duhet të përfshihen në letrën e angazhimit. (3 pikë)

(Total: 25 pikë)

Zgjidhja

(a) Partneri për angazhime të auditimit (partneri për auditime) duhet të mbajë parasysh çështjet e përgjithshme të mëposhtme:

(i) Arsyet se pse drejtorët e Konstruksioni – it dëshirojnë të caktojnë auditorë të rinj për kompaninë. Në qoftë se kjo ndodh sepse drejtorët e entitetit kanë refuzuar t'i përgjigjen pozitivisht kërkesave nga auditorët ekzistues, që gjë ka rezultuar në një prishje të marrëdhënieve të punës me ta, atëherë partneri për auditime të firmës suaj mund të mos jetë i interesuar të japë një çmim për caktimin si auditorë.

(ii) Të gjitha rreziqet që i kërcënohen pavarësisë së firmës. Mund të ketë disa lloje të rreziqeve që kërcënojnë pavarësinë ose pavarësinë e perceptuar të firmës në qoftë se konsiderohet se firma do të jetë e varur në mënyrë të papërshtatshme nga Konstruksioni si një pasojë e madhësisë së tarifave që do të merret prej tij. Në mënyrë të ngjashme në qoftë se ndonjë nga partnerët e firmës janë të lidhur në një mënyrë ose tjetër me Konstruksioni – in, atëherë legjislacioni i ndërtuar në mënyrë të tillë që të ruajë pavarësinë e auditorëve mund të mos i lejojë firmat të veprojnë si auditorë të tij.

(iii) Aftësia e firmës për të kryer auditime efikase. Një gjë e tillë do të mund të përcaktohet nga kufiri kohor deri në të cilin duhet të jepet raporti dhe të cilin e vendos kompania bashkë me burimet e auditimit që ka firma në dispozicion. Duke pasur parasysh natyrën, madhësinë dhe shpërndarjen e ambienteve të aktiviteteve të Konstruksioni – it, partneri për auditime do të duhet të mbajë parasysh me kujdes faktin nëse firma do të mund t'i shërbejë siç duhet këtij angazhimi specifik të auditimit. Disponueshmëria e personelit me njohuri dhe ekspertizë të mjaftueshme teknike mund të varet nga angazhimet e tjera të auditimit ndaj të cilave është angazhuar tashmë firma.

(iv) Konsiderimet e përgjithshme tregtare. Partneri për auditime do të duhet të jetë i sigurt se firma është në gjendje të ndërtojë një marrëdhënie të suksesshme të punës gjatë auditimit ose dhënies së shërbimeve të kontabilitetit ndaj kompanisë. Në të njëjtën kohë do të ketë nevojë të bëjë të sigurt një marrëdhënie e tillë është fitim – prurëse nga perspektiva e firmës. Si pasojë ai do të duhet të mbajë parasysh integritetin dhe praktikat e punës së drejtorëve të Konstruksioni – it bashkë me fuqitë financiare të kompanisë.

(Do t'iu jepen pikë të plota nëse përshkruani TRE nga çështjet më sipër ose çështjet e tjera përkatëse.)

(b) Faktorët e mëposhtëm kanë ndikim mbi vlerësimin e rrezikut të vetvetishëm që ka të bëjë me auditimin e pasqyrave financiare të Konstruksioni – it:

(i) Kompania është duke operuar në një treg konkurrues, ka pësuar rënie të ndjeshme në fitime dhe ka hua bankare në shuma domethënëse. Drejtorët nuk duket se e vrasin shumë mendjen për sa i takon pozicionit afarist të kompanisë. Megjithatë ata mund të kenë shtysa për të paraqitur ndryshe pasqyrat financiare në mënyrë që ta paraqesin një pozicion më të favorshëm afarist dhe të bilancit të gjendjes për të përfutur kështu besim më të madh të palëve të treta në kompani. Vlerësimi i rrezikut të vetvetishëm do të duhet të mbajë parasysh të gjitha këta faktorë, bashkë me mundësitë për problem të mundshme të hipotezës së vijimësisë më të cilat mund të haset kompania.

(ii) Vetë shpërndarja gjeografike e aktivitete të kompanisë mbi 14 vende të ndryshme, është një faktor që rrit mundësitë e pranisë së anomalive materiale në pasqyrat financiare të kompanisë. Natyra e veprimtarisë së kompanisë duket se është shumë komplekse, me vëllime të mëdha të blerjeve, shitjeve dhe në përgjithësi të transaksioneve kontabël.

Kështu pra do të ketë problem të perceptuara për sa i takon plotësisë dhe saktësisë së regjistrimit të transaksioneve në regjistrat kontabël të kompanisë dhe pasqyrimin e të njëjtave elemente në pasqyrat financiare.

(iii) Kompania ka pasur kosto domethënëse për sa i takon programit të saj për riparimin dhe ri - mobilimin e të gjitha 14 ambienteve të saj në të gjithë vendin. Këto kosto me siguri që kanë një efekt material mbi pasqyrat financiare të kompanisë dhe rishikimet e para që do të bëhen nga auditorët duhet fokusohen mbi plotësinë dhe saktësinë e regjistrimeve, përfshirë këtu kategorizimin e saktë të kostove përkatëse midis kostove të të hyrave (riparimet) dhe shpenzimit kapitale (përmirësimet) në pasqyrat financiare.

(iv) Kompania ka veprimtari të shtrira të shitjes me pakicë me anë të të cilave shet një sërë produkte. Shitjet kryhen për para e gatshme, gjë e cila i bën këto shitje veçanërisht të ndjeshme ndaj humbjeve ose keqpërdorimeve dhe kjo bashkë me fleksibilitetin 'merre vetë mallin nga dyqani ose ta sjellim ne' që i njihet shitjeve me kredi e rrit mundësinë e shitjeve të pa - regjistruara. Natyra dhe përbërja e shitjeve në secilin ambient përfshirë marrjen me qira të pajisjeve dhe veglave, është një gjë që bën që auditorët të shqetësohen për sa i takon mundësisë se pranisë së shitjeve të pa - regjistruara dhe pasaktësisë së kategorizimit e shitjeve në regjistrat kontabël të kompanisë.

(v) Stoket përfaqësojnë një përqindje të madhe të pasurive të kompanisë dhe auditorët do të jenë të shqetësuar për sa i takon mënyrës së tyre të përfshirjes në pasqyrat financiare të kompanisë. Shqetësimet do të duhet të përqendrohen mbi bazat e shprehjes me anë të termave sasiore dhe vlerësimit të stoqeve që janë përfshirë në bilancin e gjendjes të kompanisë. Për sa i takon shprehjes së stoqeve me terma sasiore, mund të ketë problem me inventarin e rërës dhe zhavorrit ndërsa problemet që kanë të bëjnë me vlerësimin mund të ketë të bëjnë me vlerat monetare që i janë artubuar artikujve individualë dhe grupeve të ndryshme të stoqeve në secilin ambient. Për shkak të bartshmërisë së artikujve të stoqeve dhe qasjes së hapur ndaj tyre, në të njëjtën kohë mund të ketë problem me mundësinë e humbjes ose përvetësimit të stoqeve.

(vi) Pasuritë jo-qarkulluese të trupëzuara të kompanisë përfshijnë një vëllim të madh të artikujve të bartshëm lehtë me vlera monetare të larta. Një gjë e tillë mund të bëjë që në fillim të auditimit të perceptohen problem dhe mund të bëjë që kësaj pjese të pasqyrave financiare të kompanisë t'i atribuohet një faktor i lartë i rrezikut të vetvetishëm. Të gjitha pasuritë që mund të barten ose transportohen lehtë e që janë në dispozicion të kompanisë janë të ndjeshme ndaj humbjeve ose përvetësimeve, por këto karakteristika janë specifikisht të zbatueshme për pasuritë jo - qarkulluese që parashtrihen si në zotërim të kompanisë, përfshirë gamën e veglave dhe pajisjeve në dispozicion për shitje. Bashkë me çështjet e ekzistencës, vlerësimi i pasurive individuale mund të shkaktojë probleme për sa i takon mundësisë së dëmtimeve dhe shkurtimeve të jetës së dobishme të pasurive që vijnë si pasojë e mjedisit relativisht të ashpër në të cilin ushtron veprimtaritë kompania.

(vii) Kompania punëson 252 (14 x 18) persona si personel me kohë të plotë në dyqane dhe depo të cilët për më tepër përforcohen nga punonjësit me kohë të pjesshme dhe punëtorët e përkohshëm, përveç atyre të punësuar në zyrat qendrore. Duke pasur parasysh numrin e atyre që fillojnë e lënë punën gjatë gjithë vitit dhe kompleksitetit e thërra që kanë të bëjnë me pagat përfshirë këtu mundësinë e pagesave për punë jashtë orarit dhe pagesat e shpërblimeve, kompania me sa duket ka një vëllim të madh e të transaksioneve me paga. Një gjë e tillë do të ngrejë shqetësime për sa i takon plotësisë dhe saktësisë së regjistrave në këtë fushë dhe mundësinë e pagesave të pa - autorizuar të rrugave dhe pagave.

(c)

(i) Letra e angazhimit ndihmon shmangien e keqkuptimeve midis auditorëve dhe klientit për sa i takon natyrës së caktimit të auditorëve në punë, objektit të punës së auditimit që duhet të kryhet

dhe përgjegjësitë përkatëse të auditorëve dhe klientit. Ajo formon bazën e kontratës midis auditorëve dhe klientit.

(ii) Të gjitha çështjet e mëposhtme janë të rëndësishme dhe duhet të përfshihen në një letër të angazhimit:

- Objektivi i auditimit të pasqyrave financiare;
- Përgjegjësitë e menaxhmentit për pasqyrat financiare;
- Objekti i auditimit, përfshirë referencat ndaj legjislacionit, rregulloreve, ose prononcimeve të organizmave profesionale to në përputhje me të cilat vepron auditori;
- Formatin e të gjitha raporteve ose mënyrave të tjera të komunikimit për sa i takon rezultateve të angazhimit;
- Faktin se për shkak të natyrës së testeve dhe kufizimeve të tjera të vetvetishme të kontrolleve të brendshme, ka një rrezik të pashmangshëm që anomalitë materiale të mbeten të pazbuluara;
- Qasjen e pakufizuar ndaj të gjithë regjistrave, dokumenteve dhe informacioneve të tjera të kërkuara në lidhje me auditimin;
- Marrëveshjet që kanë të bëjnë me planifikimin dhe kryerjen e auditimit;
- Shpjegimet për sa i takon përfuturit nga menaxhmenti të konfirmimeve të shkruara që kanë të bëjnë me deklaratimet e bëra në lidhje me auditimin;
- Kërkesa që klienti të konfirmojë kushtet e angazhimit duke nënshkruar letrën;
- Përshkrimin e të gjitha letrave ose raporteve që auditori pret t'i japë klientit;
- Bazat mbi të cilat llogariten tarifat dhe të gjitha marrëveshjet për faturime.

Detyra 2

B-Roni, një kompani prodhuese me përgjegjësi të kufizuar, i ka të gjitha ambientet e prodhimit, dyqanet dhe ndërtesat e zyrave kryesore të vendosura në një vend të vetëm. Departamenti i blerjes dhe i kontabilitetit ndodhen në ndërtesën e zyrave qendrore. Kohëve të fundit pas 'gllabërimit' të kompanisë nga menaxhmenti [pra blerjes nga aksionarët e mëparshëm], drejtorëve iu është bërë e ditur se niveli i kontrolleve të brendshme mbi sistemet e Blerjeve dhe Të Pagueshmeve tregtare është i pamjaftueshëm. Pikat e dobëta përfshijnë mungesën e procedurave të kontrollit dhe dokumentimit të duhur. Në mënyrë të ngjashme asnjëherë nuk janë bërë përpjekje për të përdorur ekstraktet e gjendjes së llogarisë tek furnitorët (kartelat e furnitorëve) për të mbështetur kontrollet brenda për brenda sistemit. Në të gjithë sistemin kontabël të kompanisë përdoret sistemi i 'regjistrimit dhe përpunimit të transaksioneve në grup', në të cilin [në sistem] përfshihen edhe librat kryesorë të të pagueshmeve dhe llogaritë e tjera të librit kryesor.

Kërkohet:

(a) Parashtroni KATËR objektivat e pasjes së kontrolleve të brendshme në një Sistem të Blerjeve dhe Të Pagueshmeve tregtare. (4 pikë)

(b) Identifikoni kontrollet e brendshme që duhet të jenë të pranishme në B-Roni mbi elementet e mëposhtme:

(i) Përpilimi i kërkesave për blerje dhe autorizimi i tyre;

(ii) Mënyra se si informohen furnitorët për marrjen e mallrave në dorëzim dhe kthimet e mallrave të blera;

(iii) Kontrolli dhe autorizimi i faturave të blerjeve para se të grupohen për t'u përpunuar me anë të sistemit të kompjuterizuar kontabël. (12 pikë)

(c) Shpjegoni mënyrën se si do të duhet të përdoren ekstraktet e gjendjes së llogarisë tek furnitorët për të mbështetur e përforcuar kontrollet në sistemin e Blerjeve dhe Të Pagueshmeve Tregtare të B-Roni. (2 pikë)

(d) Tregoni kuptimin e termit 'sistemi i regjistrimit dhe përpunimit të transaksioneve në grup' dhe shpjegoni përdorimin e totaleve kontrolluese në sisteme të tilla. (2 pikë)

(e) SNA 230 Dokumentimi i auditimit ka të bëjë me përgjegjësinë e audituesit për përgatitjen e dokumentacionit të auditimit për një auditim të pasqyrave financiare.

Kërkohet:

Përkthyesi KATËR përfitimet e dokumentimit të punës së auditimi (5 pikë)

(Total: 25 pikë)

Zgjidhja

(a) Objektivat e një Sistemi të Blerjeve dhe Të pagueshmeve Tregtare janë bërja e sigurt se:

(i) Kërkesat për mallra dhe shërbime për një entitet përpilohen vetëm kur një gjë e tillë është e duhur.

(ii) Furnizimi i mallrave dhe shërbimeve bëhet në përputhje me kërkesat e entitetit për sa i takon cilësisë dhe sasisë dhe çmimit më të mirë në dispozicion.

(iii) Vetëm mallrat dhe shërbimet që janë kërkuar më parë nga entiteti pranohen si bazë për pagesa të mëvonshme.

(iv) Faturat e paguara nga entiteti kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet që janë përftuar aktualisht.

(v) Pagesa i bëhen furnitorëve në kohën e duhur për mallrat dhe shërbimet e përftuara prej entitetit.

(vi) Të gjitha transaksionet *bona-fide* që kanë të bëjnë me blerjet e mallrave dhe shërbimeve regjistrohen në kohën e duhur në regjistrat kontabël të entitetit.

(b) Normalisht do të duhet të ekzistojnë procedurat e mëposhtme dhe dokumentimi i kontrolleve mbi:

(i) Përpilimin e kërkesave dhe autorizimin e blerjeve

- Detyra e përpilimit të kërkesave për blerjen e mallrave dhe shërbimeve duhet t'i caktohet një punonjësi specifik i cili mban këtë përgjegjësi në kompani.

- Kërkesat për blerje të mallrave dhe shërbimeve duhet të komunikohen me anë të formularëve të caktuar të cilat kanë kërkesa uniforme për sa i takon hollësive përfshirë këtu justifikimin për blerje.

- Detyra e përpilimit të urdhër – blerjeve [porosive] duhet t'i caktohet zyrtarëve përgjegjës për blerjet të B-Roni të cilët kanë funksione të ndara nga marrja e mallrave në dorëzim dhe funksionet kontabël.

- Duhet të ruhen kontrolle të rrepta mbi sigurinë e formularëve të përdorur për të dhënë urdhër – blerjet të cilët duhet të jenë të paranimëruar në mënyrë konsekuative.

- Formularët për urdhër – blerjet duhet të kenë më shumë se sa një kopje, në mënyrë që një kopje t'i dërgohet departamentit të kontabilitetit për të bërë bashkërendimin me dokumentacionin e mallrave të marra në dorëzim dhe faturat përkatëse siç duhet. Në të njëjtën kohë një kopje i duhet dërguar departamentit që merr mallrat në dorëzim në mënyrë që këta të fundit të kontrollojnë marrjet e mëpasshme në dorëzim.

(ii) Njohja e marrjes në dorëzim të mallrave dhe e kthimit të mallrave ndaj furnitorëve.

- Personeli që merr në dorëzim mallrat duhet të jetë i ndarë nga funksionet e dhënies së porosive dhe funksionet kontabël të kompanisë B-Roni.

- Të gjitha mallrat e marra në dorëzim duhet të inspektohen dhe kontrollohen me kopjet e urdhër – blerjeve për sa i takon klasifikimit, cilësisë dhe sasisë.

- Mallrat e marra në dorëzim duhet të regjistrohen në formularë të paranimëruar në mënyrë të një pas njëshme dhe me shumë kopje ndërsa një kopje i dërgohet departamentit të kontabilitetit për bashkërendim të mëtejshëm me urdhër – blerjet dhe faturat.

- Mallrat e marra në dorëzim duhet të regjistrohen në formularë të paranimëruar në mënyrë të një pas njëshme dhe me shumë kopje ndërsa një kopje i dërgohet departamentit të kontabilitetit

për t'i bashkërenduar ato me dëftesat për kreditim. Një kopje duhet të dërgohet njëkohësisht me mallrat e kthyera të specifikuar për në mënyrë që të njihet marrja në dorëzim dhe kthimi i tyre në B-Roni.

(iii) Kontrolli dhe autorizimi i faturave të blerjeve para se ato të grupohen.

– Individët që janë përfshirë në përpunimin e faturave të blerjeve me anë të sistemit kontabël të kompanisë duhet të jenë të ndarë nga funksioni i lëshimit të urdhër - blerjeve, funksioni i marrjes në dorëzim të mallrave dhe funksioni i pagesave.

– Të gjitha faturat e blerjeve që janë marrë nga B-Roni duhet t'i dërgohen menjëherë departamentit të kontabilitetit të kompanisë.

– Duhet të kontrollohen detajet e faturave dhe saktësia e tyre aritmetike (dhe të evidentohen si të tilla këto kontrole) ndërsa mospërputhjet të zgjidhen para përpunimit të mëtejshëm.

– Faturat duhet të 'bashkërendohen' me urdhër - blerjet dhe dëftesat e marrjes së mallrave në dorëzim ndërsa mospërputhjet të zgjidhen para përpunimit të mëtejshëm.

– Faturat e bashkërenduara duhet t'i dërgohen nëpunësve të përshtatshëm që janë përgjegjës në kompani për autorizim dhe miratimin e kodifikimit të llogarive (librave kryesorë) ashtu siç duhet.

– Duhet të ketë procedura të ndara të miratimit, përfshirë këtu praninë e nëpunësve të përshtatshëm e të përgjegjshëm të B-Roni, për miratimin e faturave që kanë të bëjnë me shërbimet komunale dhe shërbimet e tjera të ndryshme të përfutuara dhe që nuk i nënshtrohen procedurave normale për urdhër - blerjet dhe për marrjen e mallrave në dorëzim.

– Në rast se faturat i dërgohen nëpunësve përkatës të kompanisë, duhet të mbahet një regjistër për të ndjekur progresin e tyre siç duhet.

– Para se të grupohen, faturat duhet të para - numërohen me një në mënyrë që të mundësohet plotësia e përpunimit.

(c) Në rastet kur përftohen, ekstraktet e gjendjes së llogarisë tek furnitorët duhet të rakordohen sa më shpejt të jetë e mundur me llogaritë përkatëse të furnitorëve në regjistrin e të pagueshmeve tregtare të B-Roni. Rakordimet duhet të përgatiten nga individët që janë të ndarë nga funksionet e përpunimit të faturave të blerjeve dhe të pagesave të furnitorëve (për të parandaluar mundësinë e aktiviteteve mashtruese), megjithëse në rastet kur kjo nuk është e mundur këto ekstrakte duhet të mbahen nga afër në kontroll të vazhdueshëm.

Rakordimi i ekstrakteve të gjendjes së llogarisë tek furnitorët mbështet në të njëjtën kohë edhe kontrollet e tjera mbi blerjen dhe të pagueshmet tregtare sepse ndihmon në bërjen e sigurt të plotësisë së regjistrave, dhe identifikimin e gabimeve gjatë përpunimit të transaksioneve të librit kryesor të blerjeve. Të gjitha diferencat e identifikuar midis ekstrakteve të gjendjes së llogarisë tek furnitorët dhe llogarive të regjistrit të të pagueshmeve tregtare mund të nxjerrin në pah ekzistencën e faturave të papërpunuara për mallra ose shërbime të përfutuara, ose madje edhe faktin se janë bërë pagesa në llogari të furnitorëve, por këto nuk kanë arritur ende tek këta të fundit. Të gjitha mungesat ose gabimet e zbuluara në këtë mënyrë duhet të hetohen menjëherë.

(d) Termi 'sistemi i përpunimit në grupe të transaksioneve' përdoret për të përshkruar një sistem kontabël të kompjuterizuar, me anë të të cilit të dhënat regjistrohen dhe përpunohen në grupe të ndara. Kontrollat duhet të bëjnë të sigurt ndarjen e fortë të detyrave midis atyre që përgatisin të dhënat për përpunim; atyre që regjistrojnë të dhënat dhe atyre që bëjnë përpunimin e të dhënave me anë të sistemit kompjuterik.

Procedurat e përgatitjes duhet të përfshijnë totalët e kontroleve (parapërgatitur në lista para përpunimit) të krijuara si vlera monetare dhe si numri i dokumenteve të përpunuara ose një 'total të përzier' kundrejt të cilit përdoruesit mund të kontrollojnë të dhënat e përpunuara më tej me anë të sistemit kompjuterik dhe ato që i janë raportuar atyre pas përpunimit. Në qoftë se ka

mospërputhje midis një totaleve të listave para përpunimit dhe totalet pas përpunimit, atëherë duhet të bëhet rakordimi i menjëhershëm në mënyrë që të bëhet i sigurt integriteti i përpunimit.

(e) Dokumentimi i punës së auditimit

- Siguron dëshmi të bazës së auditorit për një përfundim në lidhje me arritjen e qëllimit të përgjithshëm të auditimit.
- Ofron dëshmi se auditimi është planifikuar dhe zbatuar në pajtim me SNA dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.
- Ndiemon ekipin e auditimit për të planifikuar dhe kryer auditimin.
- Ndiemon anëtarë e ekipit të angazhuar, përgjegjës për mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë, mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e punës audituese.
- Mundëson ekipit të angazhimit të jenë përgjegjës për punën e tyre
- Ruan një regjistër për çështjet me rëndësi të vazhdueshme për auditimet e ardhshme.

Detyra 3

(a)

(i) Duke u nisur nga perspektiva e SNA / ISA 530 *Mostrimi në auditim*, shpjegoni dhe jepni shembuj të termave 'rreziku i mostrimit' dhe rreziku i 'mos-mostrimit'. (4 pikë)

(ii) Shpjegoni shkurtimisht mënyrën se si mund të kontrollohen rreziku i mostrimit dhe i mos- mostrimit nga një firmë auditimi. (2 pikë)

(b) KAZ ShPK, menaxhohet nga dy vëllezër të cilët kanë në pronësi pjesë të barabarta të kompanisë. Kompania është specializuar në shitjen e automjeteve të shtrenjta. Të hyrat vjetore nga shitja janë përafërsisht € 70,000,000 dhe sipas legjislacionit vendor, kompania duhet të bëjë një auditim. Çdo vit shiten rreth 500 automjete, me një vlerë mesatare prej € 140,000, megjithëse vlerat variojnë nga € 130,000 në € 160,000. Faturat mbushen me dorë ndërsa një nga drejtorët i nënshkruan të gjitha faturat për të konfirmuar se vlera e shitjeve është e saktë. Të gjitha përgatitjet e regjistrave kontabël dhe pasqyrave financiare kryhen nga drejtorët. Zgjerimi i mëtejshëm i ekspozitës së kompanisë u financua nga një kredi bankare, e ri - pagueshme për pesë vjet. Menaxheri i auditimit ka filluar të planifikojë auditimin e KAZ ShPK. Udhëheqësi i auditimit dhe ndihmësi i auditimit të cilëve iu është caktuar kryerja e auditimit janë duke ndihmuar menaxherin për të trajnuar kështu edhe ndihmësin e auditimit. Në fakt është duke u komentuar mënyra se si do të duhet të zgjidhet për t'u testuar një shembull nga faturat e shitjeve. Normalisht që duhet të kryhen procedura të tilla të auditimit të cilat bëjnë të sigurt se drejtori menaxhues i ka nënshkruar faturat në fjalë dhe më pas të kontrollohen detajet përkatëse me librin ditor të shitjeve dhe librin kryesor të shitjeve. 'Ne duhet të kontrollojmë të gjitha faturat' sugjeron menaxheri i auditimit. 'Po sikur të zgjedhim një mostër duke përdorur teknikat e mostrimit statistikor' shton udhëheqësi i auditimit. 'Pse të humbim kohë me zgjedhjen e një mostre në mënyrë statistikore?' pyet ndihmësi i auditimit. 'Zgjedhja e mostre të faturave nga dosja e faturave që po rishikohen dhe zgjedhja me dorë e disa faturave të rëndësishme do të jetë shumë më e shpejtë.'

Kërkohet:

(i) Shpjegoni shkurtimisht secilën nga metodat e zgjedhjes së mostrave të sugjeruara nga menaxheri i auditimit, udhëheqësi i auditimit dhe ndihmësi i auditimit, dhe diskutoni faktin nëse ato janë të përshtatshme apo jo për të përfutur një mostër përfaqësuese të faturave të shitjeve. (9 pikë)

(ii) Përkufizoni 'materialitetin' dhe shpjegoni se pse auditorët e KAZ ShPK duhet të formulojnë një opinion mbi faktin nëse pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale. (5 pikë)

(iii) Shpjegoni ndryshimin në mes të auditimit të ndërmjetëm dhe auditimit përfundimtar dhe shpjegoni punët e auditimit që kryhen në këto faza të ndryshme. (5 pikë)

(Total: 25 pikë)

Zgjidhja

(a)

Rreziku i mostrimit

(i) Rreziku i mostrimit është vjen nga mundësia që konkluzioni i auditorit, bazuar në një mostrim, mund të jetë i ndryshëm nga konkluzioni që mund të nxirrej, nëse e gjithë popullata do të ishte subjekt i së njëjtës procedurë auditimi. Auditori, nga rezultatet e testimit mund të arrijë në përfundimin se ekzistojnë anomali materiale, kur në fakt ato nuk ekzistojnë, ose që nuk ekzistojnë anomali materiale kur në fakt ato ekzistojnë.

(ii) Rreziku i mostrimit kontrollohet nga vetë firma e auditimit për të bërë të sigurt se është duke u përdorur një metodë e vlefshme e zgjedhjes së zërave ose artikujve nga një popullatë e caktuar dhe/ose duke rritur madhësinë e mostrës. .

Rreziku i mos - mostrimit

(i) Rreziku i mos - mostrimit vjen si rezultat i faktorëve të cilët mund të bëjnë që auditori të arrijë një konkluzion të gabuar për shkak të arsyeve të cilat nuk kanë të bëjnë me madhësinë e mostrës. Për shembull, për faktin që shumica e evidencës së auditimit është më shumë për të krijuar bindje se sa konkluzione, apo që auditori mund të përdorë procedura të papërshtatshme, ose të keqinterpretojë evidencën dhe kështu të dështojë në gjetjen e gabimit ose gabimit. Shembuj të rrezikut të mos - mostrimit përfshijnë përdorimi e procedurave të pa - përshtatshme, keqinterpretimin e evidencave ose thjeshtë kur auditori nuk 'e vë re' një gabim.

(ii) Rreziku i mos - mostrimit kontrollohet me anë të trajnimeve të duhura dhe të përshtatshme për personelin në mënyrë që ata të dinë se cilat teknikat e auditimit të përdorin dhe të njohin një gabim sa herë që ai ndodh.

(b) (i) Menaxheri i auditimit sugjeron kontrollin e të gjitha faturave, duke injoruar efektivisht të gjithë mostrimin statistikor; me fjalë të tjera ky është mostrimi jo - statistikor. Testet e auditimit duhet të zbatohen për të gjitha faturat e shitjeve. Kjo qasje mund të jetë e përshtatshme për auditimin e KAZ për arsye se:

- Popullata është relativisht e vogël dhe ka shumë gjasa që të gjitha transaksionet dhe artikujt të testohen më shpejt në krahasim me kohën e harxhuar për të ndërtuar një shembull.

- Të gjitha transaksionet nuk janë të mëdha për sa i takon vlerave monetare por mund të konsiderohen materiale në vetvete, p. sh. në krahasim me tërë projektin. Meqenëse të gjitha transaksionet janë materiale, atëherë të gjitha transaksionet duhet të testohen.

Udhëheqësi i auditimit sugjeron përdorimin e mostrimit statistikor. Kjo do të thotë zgjedhja e një numri të kufizuar të faturave të shitjeve nga popullata duke përdorur teorinë e probabilitetave e cila mundëson zgjedhjen e rastësishme të mostrës dhe më pas zbatimin e testeve të auditimit vetëm ndaj këtyre faturave. Kjo qasje mund të jetë e përshtatshme për arsye se:

- Popullata përbëhet nga zëra dhe artikuj të ngjashëm (pra është homogjene) dhe nuk ka tregues që sistemi i kontroleve nuk funksionon ose që ka ndryshuar gjatë vitit. Çështja ka të bëjë me faktin se sa kohë do të duhet për të përcaktuar dhe përfutur një mostër, gjë e cila mund të bëjë që mostrimi statistikor të mos jetë i përshtatshëm në këtë situatë.

Ndihmësi i auditimit sugjeron përdorimin e mostrimit të 'rastësishëm', të cilin me sa duket auditori i ri e kupton si zgjedhja manuale e faturave që duhet të shqyrtojë. Qasja pra kë të bëjë me një element anësie dhe është nuk është mostrim statistikor ose vërtet i 'rastësishëm'.

Ndërsa qasja duket se kursen kohë, nuk është e përshtatshme për arsye se:

- Mostra e zgjedhur nuk do të zgjidhet 'rastësisht' por sipas tekave të auditorit. Natyra njerëzore do të tentojë të shmangë zërat dhe artikujt e vështirë për t'u testuar.

- Në të njëjtën kohë, meqenëse faturat nuk do të jenë zgjedhur duke përdorur mostrimin statistikor, nuk mund të zgjidhen konkluzione të vlefshme nga rezultatet e testeve. Në qoftë se gjendet një gabim do të jetë shumë e vështirë ekstrapolimi i gabimit në të gjithë popullatën.

(ii) Informacionet janë materiale nëse mungesa ose anomalia e tyre influencon në mënyrë të arsyeshme vendimet e personave të cilëve iu drejtohet raporti i auditorit.

Materialiteti varet nga madhësia e zërit ose gabimit, e gjykuar kjo në rrethanat specifike të mungesës ose anomalisë së saj. Është e rëndësishme që auditorët të bëjnë të sigurt se pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale për arsyet e mëposhtme:

- Ekzistojnë kërkesa ligjore për sa i takon auditimit të pasqyrave financiare dhe dhënies së një opinion mbi këto pasqyra financiare. Në qoftë se auditorët nuk zbulojnë një gabim material atëherë opinion i tyre mbi pasqyrat financiare nuk do të jetë i saktë

- Ka vetëm dy pronarë / drejtorë të cilët do të jenë përdoruesit fillestarë të pasqyrave financiare. Ndërsa pronarët/drejtorët mbajnë regjistrat kontabël, drejtorët do të dëshirojnë të dinë nëse ka anomali materiale të cilat dalin në pah si rrjedhojë e gabimeve që mund të jenë bërë prej tyre; auditori ka një përgjegjësi ndaj anëtarëve [të ekuitetit] për të bërë të sigurt se pasqyrat financiare janë materialisht të sakta.

- Në të njëjtën kohë ka edhe përdorues të tjerë të pasqyrave financiare në të cilët përfshihen autoritetet tatimore dhe bankat të cilët i kanë lejuar kredi kompanisë. Kështu këto palë do të duan të shohin pasqyra financiare 'të vërteta e të sigurt'. Auditorët duhet pra të bëjnë pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale për të shmangur të gjitha detyrimet ligjore ndaj palëve të treta që mund të dalin në pah në qoftë se gjenden neglizhenca gjatë auditimit të pasqyrave financiare.

(iii) Auditimi i ndërmjetëm, ashtu siç sugjeron edhe emri është pjesa e auditimit të përgjithshëm që kryhet para fundit të vitit. Auditori përdor auditimin e ndërmjetëm për të kryer procedura të cilat do të ishin vështirë të kryeshin në fund të vitit për shkak të presionit kohor. Auditimi përfundimtar, në anën tjetër, ndodhë pas përfundimit të vitit dhe përfundon me një opinion të dhënë nga auditori mbi pasqyrat financiare për tërë vitin nën auditim. Është me rëndësi të theksohet se opinion i përfundimtar merr marasysh konkluzionet e arritura edhe gjatë auditimit të ndërmjetëm edhe atij përfundimtar.

Puna tipike e kryer gjatë auditimit të ndërmjetëm përfshinë:

- Marrja parasysh e rreziqeve të vetëvetishme me të cilat ballafaqohet kompania.

- Regjistrimi i sistemit të kontrollit të brendshëm

- Kryerja e testeve të kontrollit mbi sistemet e kontrollit të brendshëm të kompanisë dhe vlerësimi i efektivitetit të këtij sistemi për të përcaktuar nivelin e rrezikut të kontrollit

- Kryerja e testeve të mjaftueshme thelbësore të transaksioneve dhe saldove për t'u bindur se librat dhe të dhënat financiare janë bazë e besueshme për përgatitjen e pasqyrave financiare.

- Identifikimi i problemeve të mundshme që mund të ndikojnë punën përfundimtare të auditimit. Qëllimi kryesor është të sigurohemi sa është e mundur se nuk ka probleme të pazbuluara në fund të vitit.

Puna tipike e kryer në ekzaminimin përfundimtar përfshinë:

- Përcjellja e procedurave për zërat e identifikuar gjatë numërimit të stokeve.

- Përfëtimi i konfirmimeve nga palët e treat siç janë bankierët dhe avokatët/juristët.

- Rishikimi analitik (procedura analitike) të zërave të pasqyrave financiare..

- Rishikimi i ngjarjeve pas periudhës raportuese.

- Konsiderimi i parimit të vijimësisë së organizatës.

Detyra 4

(a) Përkufizoni 'hipotezën e vijimësisë' dhe diskutoni përgjegjësitë e auditorit për sa i takon përmbushjes së hipotezës së vijimësisë nga kompania. (5 pikë)

(b) Ju jeni menaxheri i auditimit në firmën e auditimit Gjeli. Një nga klientët tuaj të auditimit është Sportisti ShPK, një kompani e cila është specializuar në prodhimin dhe shitjen e pajisjeve sportive. Sportisti ShPK ka qenë klient i auditimit për pesë vjet dhe ju keni qenë menaxheri i auditimit për tre vjetët e kaluar ndërsa partneri për auditime ka mbetur po ai që ka qenë. Tani jeni duke planifikuar auditimin për vitin që mbaron në datën 31 Dhjetor 2015. Nga takimi fillestar me drejtorët e Sportisti ShPK, keni përftuar informacionet e mëposhtme:

-
- (i) Sportisti ShPK është duke u përpjekur të regjistrohet në një nga bursat e mirënjohura të këmbimit të aksioneve dhe letrave me vlerë. Drejtorët kanë themeluar një komitet të auditimit, ashtu si kërkohet nga rregulloret e qeverisjes së korporatës, megjithëse nuk janë ndërmarrë veprime të mëtejshme për sa i takon këtij aspekti. Informacionet që kanë të bëjnë me regjistrimin në bursë nuk janë ende të ditura publikisht.
- (ii) Juve iu është kërkuar të vazhdoni të përgatisni pasqyrat financiare të kompanisë, siç keni bërë në vitet e kaluara.
- (iii) Si auditorë të kompanisë që jeni, Sportisti ShPK do të dëshironte që ju dhe partneri për auditime të merrnit pjesë në një pritje, në mbrëmjen e ardhshme në një hotel, ku Sportisti ShPK do të paraqesë marrëveshjet e tyre për t'u regjistruar në bursë, ndaj bankave dhe aksionarëve të mëdhenj ekzistues.
- (iv) Sportisti ShPK ka treguar se tarifat për shërbimet tatimore që janë kryer gjatë vitit që mbaron në datën 31 Dhjetor 2014 do të paguhet sapo autoritetet tatimore të kenë aprovuar saktësinë e detyrimeve tatimore të kompanisë. Ju i keni dhënë këshilla Sportisti ShPK për sa i takon ligjshmërisë së zërave të caktuar si 'të lejueshëm' për qëllim tatimore mirëpo autoriteti tatimor është duke i kundërshtuar këto zëra.
- Së fundi sapo keni trashëguar, 5% të kapitalit aksionar të Sportisti ShPK si trashëgimi nga vdekja e një kushëriri të largët.
-

Kërkohet:

(i) Identifikoni, dhe shpjegoni relevancën e të gjithë faktorëve të cilët mund të kërcënojnë pavarësinë e Gjeli gjatë auditimit të pasqyrave financiare të Sportisti ShPK për vitin që mbaron në datën 31 Dhjetor 2015. Shpjegoni shkurtimisht mënyrën se si duhet të menaxhohet secili kërcënim. (10 Pikë)

(ii) Shpjegoni veprimet që duhet të ndërmarrë bordi i drejtorëve të Sportisti ShPK në mënyrë që të përmbushë kërkesat për qeverisje të korporatës që i Sportisti ShPK të mund të regjistrohet në bursë. (6 Pikë)

(iii) Shpjegoni arsyet se pse firma e auditimit do të ketë nevojë të komunikojë me komitetin e auditimit të Sportisti ShPK për sa i takon këtij auditimi dhe auditimeve të ardhshme. (4 Pikë)

(Totali: 25 pikë)

Zgjidhja

(a) Hipoteza e vijimësisë

Hipoteza e vijimësisë është supozimi që një entitet do të vazhdojë të operojë në një të ardhme të parashikueshme; dhe se sipërmarrja nuk ka as qëllimin, as nevojën të likuidojë ose të shkurtojë në mënyrë të ndjeshme shkallën e operacioneve të saj e as nevojën që të kërkojë mbrojtje ligjore prej kreditorëve në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Si rezultat, pasuritë dhe detyrimet vlerësohen mbi bazën e përdorimit në vazhdim të metodave të tilla, si kostoja historike ose kostoja e zëvendësimit dhe jo në bazë të vlerës neto të realizueshme apo vlerës së likuidimit, për arsye se mendohet se entiteti do të jetë i aftë të përftojë përfitime ekonomike prej pasurive të veta dhe se do të jetë i aftë të paguajë detyrimet. Ky është një nga konceptet themelore që përdoren nga auditorët dhe që parashtrohet në SNK / IAS 1 *Paraqitja e pasqyrave financiare*.

Përgjegjësia e auditorit për sa i takon hipotezës së vijimësisë shpjegohet në SNA / ISA 570 *Hipoteza e vijimësisë*. Parashtron se 'gjatë planifikimit dhe kryerjes së procedurave të auditimit dhe vlerësimit të rezultateve përkatëse, auditori duhet të mbajë parasysh përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit, gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare', dhe 'të mbajë parasysh të gjitha shënimet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare'.

Përgjegjësitë e auditorit i takojnë kryesisht:

- (i) Kryerjen e procedurave të përshtatshme të auditimit të cilat do të identifikojnë faktin nëse një organizatë mund të vazhdojë të përmbushë hipotezën e vijimësisë.
- (ii) Për të bërë të sigurt se menaxhmenti i organizatës ka qenë realist për sa i takon përdorimit të hipotezës së vijimësisë gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare.
- (iii) Raportimi ndaj anëtarëve në rsat se ata konsiderojnë se hipoteza e vijimësisë është përdorur në mënyrë të pa - përshtatshme, për shembull, në rast se pasqyrat financiare tregojnë se organizata e përmbush hipotezën e vijimësisë, ndërsa procedurat e auditimit tregojnë se kjo nuk është e vërtetë.

(b)

(i) Kërcënimet ndaj pavarësisë

Qarkullimi i partnerit për auditime

Sportisti ShPK ka pasur të njëjtin partner për auditime për pesë vjetët e fundit. Pavarësia e partnerit për auditime mund të dëmtohet nëse një pozicion i tillë mbahet për më shumë se pesë vjet për një kompani të regjistruar në bursë. Arsyet pas kësaj janë që partneri është shumë afër drejtorëve dhe personelit në firmë dhe një gjë e tillë mund të dëmtojë gjykimin mbi pasqyrat financiare. Megjithatë, Sportisti ShPK aktualisht nuk është i regjistruar në bursë prandaj kjo kërkesë nuk është e aplikueshme.

Meqenëse Sportisti ShPK tani është i regjistruar në bursë, Gjeli duhet të qarkullojë partnerin për auditime këtë vit për të shmangur të gjitha kërcënimet e familjaritetit. Megjithatë, duke pasur parasysh se Sportisti ShPK nuk ishte një kompani e regjistruar në bursë deri sa filloi ky auditim, mund të nënkuptohet se partneri mund të vazhdojë këtë vit, por do të duhet të qarkullojë para auditimit të vitit 2016.

Përgatitja e pasqyrave financiare

Me sa duket Gjeli ka qenë duke përgatitur pasqyrat financiare të Sportisti ShPK – t duke dhënë në të njëjtën kohë shërbime të auditimit të vitet e mëparshme. Ndërsa kjo mund të mos ketë qenë një çështje që cenon pavarësinë në të kaluarën, ka shumë gjasa që të kërcënojë pavarësinë tani, për shkak se në shumicën e juridiksioneve auditorëve nuk iu lejohet të japin shërbime të tjera ndaj klientëve të tyre të auditimit, sidomos klientëve që janë të regjistruar në bursë. Përgatitja e pasqyrave financiare bashkë me auditimin e tyre do të bëjë që Gjeli të përballet me një kërcënim të vetë - rishikimit, gjë që do të thotë që auditorët të mos jenë të aftë të shohin gabimet, ose të mos kenë dëshirë të raportojnë gabimet në materialin që kanë përgatitur më parë vetë. Gjeli duhet pra të mos pranojë të përgatisë pasqyrat financiare të Sportisti ShPK

Ndjekja e ngjarjes sociale

Ndjekja e një ngjarjeje sociale që ka të bëjë me regjistrimin në bursë mund të mos jetë diçka e përshtatshme meqenëse Gjeli mund të shihet si dikush që mbështet Sportisti ShPKn në këtë

sipërmarrje. Ka pra një kërcënim të mbrojtjes ndaj pavarësisë. Mbështetja për klientin mund të nënkuptojë se firma e auditimit është “shumë afër” ndaj atij klienti duke humbur në këtë mënyrë pikëpamjen e pavarur për sa i takon auditimit. Kjo është në të njëjtën kohë një kërcënim i familjaritetit. Gjeli duhet të pra, që me edukatë të mos pranojë të marrë pjesë në darkë, duke treguar qartazi arsyet.

Tarifat e papaguara për shërbimet për tatime

Tarifat e papaguara për shërbimet e tatimeve mund të interpretohen si një kredi e dhënë ndaj klientit të auditimit. Firmat e auditimit duhet të mos japin ose marrin kredi nga klientët e auditimit. Kreditë që nuk janë paguar ende do të kenë ndikim mbi pavarësinë meqenëse shlyerja e kredisë mund të shihet si diçka më shumë e rëndësishme se sa dhënia e një opinionit të përshtatshëm të auditimit.

Gjeli duhet të diskutojë përsëri situatën me Sportisti ShPK - n, duke i sugjeruar se duhet të paguhet e gjithë tarifa në llogarinë bankare. Në mënyrë alternative, puna e auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2015 mund të shtyhet derisa të paguhet tarifa për vitin paraardhës.

Trashëgimia

Partneri për auditime nuk ka të drejtë të mbajë aksionet e një kompanie klient. Ky provizion përfshijnë personelin e auditimit sa herë që këta të fundit përfshihen në auditime. Çështja e pavarësisë është thjeshtë ajo që aksionari (auditori në këtë rast) mund të jetë më shumë i interesuar në vlerën e aksioneve se sa në dhënien e një opinion “të saktë” mbi pasqyrat financiare.

Aksionet duhet të hiqen nga dora sa më shpejt të jetë e mundur. Megjithatë, duke pasur njohuri për regjistrimin e kompanisë në bursë, si shitja tani si shitja disa ditë më pas për të përfutur një çmim më të mirë mund të konsiderohet si “tregti duke pasur në dorë informacione të brendshme”. Mund të jetë më mirë që menaxheri i auditimit të japë dorë heqjen menjëherë nga auditimi për të kufizuar të gjitha problemet aktuale ose të mundshme me pavarësinë. Auditori mund të ketë nevojë për këshilla profesionale në kohën kur shet aksionet.

(ii) Përmbushja e kërkesave të qeverisjes së korporatës

Për momentin, i vetmi veprim që duket se është ndërmarrë nga drejtorët është themelimi i një komiteti të auditimeve. Duke pasur parasysh se Sportisti ShPK do të regjistrohet në një bursë të mirënjohur, atëherë vetë kompania do të duhet të përmbushë kërkesa të tjera të qeverisjes së korporatës. Këto kërkesa përfshijnë:

- Bërja e sigurt se kryetari i bordit dhe Kryeshefi ekzekutiv i kompanisë (CEO) janë dy njerëz të ndryshëm.
- Caktimi i drejtorëve jo - ekzekutivë në bordin e Sportisti ShPKt. Numri i drejtorëve jo - ekzekutivë duhet të jetë i njëjtë me numrin e drejtorëve ekzekutivë minus kryetari.
- Bërja e sigurt se të paktën njëri nga drejtorët jo - ekzekutivë ka eksperiencën relevante financiare.
- Caktimi i drejtorëve jo - ekzekutivë tek komiteti i auditimeve, komiteti për kompensime dhe mundësisht tek një komitet për caktime në detyrë. Kryetari i bordit duhet në të njëjtën kohë të ketë nga një vend në të gjitha këto komitete.
- Themelimi i një departamenti të auditimit të brendshëm për të rishikuar sistemet e kontrolleve të brendshme të Sportisti ShPKt dhe për të bërë raportet për komitetin e auditimeve.
- Bërja e sigurt se Sportisti ShPK ka një sistem të përshtatshëm të kontrolleve të brendshme dhe se drejtorët janë në dijeni të përgjegjësive të tyre për themelimin dhe vënien në funksion të këtij sistemi.
- Themelimi i procedurave për të ruajtur kontaktet me aksionarët institucionalë dhe të gjithë aksionarët e tjerë kryesorë. Pritja në mbrëmje për aksionarët mund të bëhet një ngjarje e rregullt në këtë aspekt.

- Kontrolli i faktit se raportet vjetore financiare përmbajnë informacione mbi qeverisjen e korporatës ashtu siç kërkohet nga bursa e këmbimit të aksioneve dhe letrave me vlerë (p. sh. një raport mbi mënyrën se si drejtorët monitorojnë sistemet e kontrolleve të brendshme).

(iii) Komunikimet me komitetin e auditimeve

Sipas shumicës së sistemeve të qeverisjes së korporatës, pika kryesore e kontaktit të auditorëve të jashtëm me një kompani është komiteti i të auditimeve. Ka disa arsye të ndryshme për një gjë të tillë:

- Së pari, për të bërë të sigurt se ruhet pavarësia midis bordit të drejtorëve dhe firmës së auditimit. Komiteti i auditimeve përbëhet nga drejtorët jo - ekzekutivë, të cilët nga përkufizimi janë të pavarur nga kompania dhe në këtë mënyrë mund të kenë një pikëpamje objektive ndaj raportit të auditimit.
- Komiteti i auditimeve do të ketë më shumë kohë për të rishikuar raportin e auditimit dhe komunikimet e tjerë ndaj kompanisë nga auditori (p. sh. deklaratimet e menaxhmentit) dhe jo ndaj bordit. Auditori do të përfitojë nga fakti se raportet e tyre do të rishikohen me kujdes.
- Komiteti i auditimeve mund të bëjë të sigurt se janë implementuar të gjitha rekomandimet nga auditorët. Komiteti i auditimeve ka drejtorë jo - ekzekutivë të pavarur të cilët mund të ushtrojnë trysni mbi bordin në mënyrë që ky i fundit të ndërmarrë veprime sipas rekomandimeve të auditorit.
- Komiteti i auditimeve në të njëjtën kohë ka më shumë kohë për të rishikuar efektivitetin dhe efikasitetin e punës së auditorëve të jashtëm se sa ka bordi. Komiteti mund pra të bëjë rekomandime për sa i takon ri - caktimit të auditorëve, ose të rekomandojë një firmë të ndryshme në qoftë se firma aktuale bëhet e pa - përshtatshme.